

Statistikat e Pylltarisë dhe Biodiversitetit, 2024

Tiranë, më 08 Shtator 2025: Në vitin 2024, fondi pyjor dhe kulloror i Shqipërisë shtrihet në një sipërfaqe prej 1.731.891 hektarësh, duke përfaqësuar 60,2 % të sipërfaqes së përgjithshme të vendit.

Sipas Bilancit Kadastral të Fondit Pyjor dhe Kulloror:

- 66,2 % e fondit është e zënë me pyje (1.146.723 ha),
- 25,9 % me kullota dhe livadhe (449.167 ha),
- 7,9 % sipërfaqe me bimësi pyjore dhe joproductive (136.001 ha).

Vëllimi i përgjithshëm i pyjeve në vitin 2024 arrin në 53.145.660 m³, prej të cilave 93,9 % përbëhen nga pyje publike dhe 6,1 % nga pyje private.

Zonat e mbrojtura

Në vitin 2024, rrjeti i zonave të mbrojtura në Shqipëri përbëhej nga 777 zona, me një sipërfaqe prej 624.611 hektarësh. Krahësuar me vitin 2023, kur ishin 776 zona me sipërfaqe 626.045 ha, vihet re një rritje e lehtë në numër, por një ulje prej rreth 1.434 ha në sipërfaqe totale.

Ndryshimet sipas kategorive

- Parqet Kombëtare: Nga 13 në vitin 2023, u reduktuan në 12 në vitin 2024. Sipërfaqja ra nga 315.304 ha në 313.924 ha. Parqet kombëtare vijojnë të mbeten kategoria më e rëndësishme, duke mbuluar 50,2 % të sipërfaqes së zonave të mbrojtura.
- Monumentet Natyrore: Numri mbeti i pandryshuar (724), por sipërfaqja ra ndjeshëm, nga 1.585 ha në vetëm 86 ha. Kjo rënie lidhet me ndryshime metodologjike në matjen dhe klasifikimin e këtyre zonave, dhe ato përfaqësojnë vetëm 0,01 % të sipërfaqes së zonave të mbrojtura.
- Rezervatet Natyrorë të Menaxhuar / Parqet Natyrore: Numri u ul nga 30 në 28 dhe sipërfaqja nga 222.049 ha në 217.385 ha, duke mbuluar 34,8 % të sipërfaqes së zonave të mbrojtura.
- Peizazhet e Mbrojtura: U rritën nga 9 në 11 zona, por sipërfaqja ra nga 87.107 ha në 81.917 ha. Në vitin 2024 ato përfaqësojnë 13,1 % të zonave të mbrojtura.

Për publikim 08/09/2025

- Zonat e Burimeve të Menaxhuara: Kjo kategori përfshin 2 zona me një sipërfaqe prej 11.300 ha, që përfaqëson 1,8 % të totalit.
- Rezervat Strikte Natyrore: Nuk ka zona të shpallura në këtë kategori.

Përqindjet ndaj territorit të vendit

Në vitin 2024, zonat e mbrojtura përbënin:

- 36,0 % të sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullosor, dhe
- 21,7 % të sipërfaqes së përgjithshme të Shqipërisë.

Tab. 1 Bilanci Kadastral i Fondit Pyjor dhe Kullosor të Shqipërisë

Viti	Pyje		Kullota		Sipërfaqe me bimësi pyjore dhe jo-produktive		Gjithsej	
	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%
2022	1.146.725	66,2	449.175	25,9	136.001	7,9	1.731.901	100
2023	1.147.281	66,2	449.436	25,9	136.152	7,9	1.732.869	100
2024	1.146.723	66,2	449.167	25,9	136.001	7,9	1.731.891	100

Metodologjia

Të dhënat mbi statistikat e pyjeve dhe biodiversiteti mbështeten në të dhënat administrative vjetore. Institucioni përgjegjës për të grumbulluar këto të dhëna është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucione të tjera përgjegjëse në varësi të saj si Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Sipas VKM nr. 433, datë 8.6.2016, për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, bashkitë kanë detyrimin ligjor të raportojnë çdo tre muaj pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave të pyjeve dhe biodiversitetit është Programi i Statistikave Zyrtare 2022–2026, duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përkufizime

Kadastra e pyjeve: është një dokument zyrtar (regjistër), ku evidentohen, pasqyrohen, mbahen e përditësohen të dhënat fillestare për çdo njësi të ekonomisë pyjore apo për pellgjet ujëmbledhëse, të dhënat për ndryshimet periodike në vëllime, sipërfaqet dhe hartat përkatëse.

Fond pyjor: është sipërfaqja e mbuluar me pyje, shkurre, toka me bimësi pyjore, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtat), sistemet agropyjore, brezat mbrojtës, infrastrukturën përkatëse, si dhe pasuritë jopyjore bashkëshoqëruese, të cilat krijojnë një mjedis unik me pyjet e tokën pyjore

Fond kullor: është sipërfaqja e kullotave dhe e livadheve natyrore, shtetërore, komunale dhe private, infrastrukturat e tyre, sipërfaqet e fondit pyjor me drurë e shkurre, që përdoren si kullota, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura shkëmbore në brendësi të tyre.

Toka me bimësi pyjore: janë terrene me drurë dhe shkurre me madhësi mbi 0.5 ha, me një shkallë mbulimi deri 10 për qind.

Zonë e Mbrojtur: Sipas IUCN “është një hapësirë gjeografike e mirë përcaktuar, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar përmes mënyrave ligjore ose metodave të tjera efektive, që sigurojnë mbrojtjen afatgjatë të natyrës dhe shërbimeve mjedisore të ekosistemeve që lidhen me të, si dhe vlerave kulturore”.

Park kombëtar: shpallen territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, që ruhen dhe menaxhohen për mbrojtjen e ekosistemeve, llojeve, për edukim dhe rekreacion (çlodhje e argëtim), që rregullojnë përdorimin e qëndrueshëm nga ana e njeriut të burimeve natyrore.

Monument natyror: është një hapësirë e vogël apo objekt natyror me vlera të veçanta shkencore, historike, estetike ose kulturore, i cili mbrohet me ligj për ruajtjen e tipareve të tij unike. Këtu përfshihen shpella, burime, pemë të rralla, formacione shkëmbore, ujëvara etj.

Rezervat natyrore të menaxhuara: janë zona ku ruhet dhe menaxhohet një ekosistem natyror, duke lejuar ndërhyrje të kontrolluara për të mbrojtur biodiversitetin dhe habitatet. Parqet natyrore janë zona më të mëdha me vlera ekologjike dhe kulturore, ku synohet ruajtja e peizazheve dhe florës e faunës.

Peizazhi i mbrojtur: është një territor që karakterizohet nga një harmoni e veçantë e natyrës dhe ndërhyrjeve njerëzore, me vlera të larta natyrore, kulturore dhe estetike, dhe që mbahet në mënyrë që të ruajë këto karakteristika.

Zonat e Burimeve të Menaxhuara: janë zona të dedikuara për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, ku shfrytëzimi i pyjeve, florës, faunës ose burimeve të tjera natyrore bëhet në mënyrë të kontrolluar për të siguruar ruajtjen afatgjatë të tyre.

Rezervatet Strikte Natyrore: janë zona me mbrojtje maksimale ku nuk lejohet ndërhyrje njerëzore, përveç kërkimeve shkencore, me qëllim ruajtjen e ekosistemeve natyrore në gjendjen e tyre origjinale dhe natyrore.